UDHËZIM
Nr. 438, datë 9.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË 18.11.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT",
TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 17, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Pas paragrafit të dytë të pikës 2, të nenit 6, shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht nga përcaktimet e paragrafit të dytë, të pikës 2 të këtij neni, licencat për shërbimin e rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve, që do të lëshohen pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të kenë afat deri më 31 mars 2022.

Paragrafi i dytë i pikës 6, të nenit 6, ndryshohet si më poshtë:

"Licenca për shërbimet e rregullta të udhëtarëve lëshohet e shoqëruar me numrin e nevojshëm të certifikatave të operimit të mjeteve. Një subjekt pajiset me certifikatat e operimit për mjetet që ka kërkuar, duke plotësuar numrin e nevojshëm të mjeteve që duhet për operimin në linjat e kërkuara. Në rast se subjekti i licencuar aplikon për të zëvendësuar mjet, certifikata lëshohet vetëm në rast se provohet që mjeti për të cilën kërkohet certifikata është ekuivalent në vit prodhimi dhe cilësi me mjetin me të cilin subjekti ka aplikuar për licencë sipas nenit 9 të këtij udhëzimi. Në rast se subjekti i licencuar aplikon për të shtuar mjet, certifikata lëshohet vetëm në rast se mjeti është me vit prodhimi më së paku ekuivalent me mjetin më të ri me të cilin operon subjekti.

Numri i mjeteve në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta dhe ndryshimi i orareve, përcaktohet nga zyra e licencave në bazë të frekuencës së udhëtimeve, distancës së udhëtimit dhe mjeteve rezervë që duhet të ketë subjekti transportues.".

Neni 2

Paragrafi i parë, pika 6, i nenit 11, ndryshohet si më poshtë:

"6. Autoriteti përgjegjës i licencimit, nëpërmjet një Komisioni Vlerësues të përcaktuar nga titullari, me përbërje nga drejtoria përgjegjëse e politikave të transportit, drejtoria përgjegjëse e licencimit dhe drejtoria përgjegjëse për çështjet juridike, përzgjedh me konkurs të hapur, subjektin kandidat për të operuar në një linjë të rregullt ndërqytetëse udhëtarësh, në rastet kur:".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri